



GJENDJA FINANCIARE DHE HUAMARRJA E FAMILJEVE NË SHQIPËRI

Gjashtëmuji i parë 2019

**BANKA E SHQIPËRISË
DEPARTAMENTI I STABILITETIT FINANCIAR**

Gusht 2019

PERMBAJTJA

Përmbledhje e gjetjeve kryesore të Vrojtimit mbi Gjendjen Financiare dhe Huamarrjen e Familjeve.....	3
1 -Karakteristikat demografike dhe financiare të familjeve të intervistuar.....	4
2- Huamarrja e familjeve.....	6
3- Ngarkesa në borxh e familjeve.....	11
4- Pasuria e familjeve.....	13

Përmbledhje e gjetjeve kryesore të Vrojtimit mbi Gjendjen Financiare dhe Huamarrjen e Familjeve:

Vrojtimi i gjendjes financiare dhe huamarrjes së familjeve kryhet që prej vitit 2010, me një frekuencë gjashtëmujore. Ky vrojtım u realizua në periudhën maj-qershor, 2019, duke pasur në fokus zhvillimet në gjysmën e parë të vitit 2019, ndërsa pritshmëritë i referohen gjysmës së dytë të vitit 2019. Në këtë vrojtım, u përfshi një kampion rastësor prej rreth 2010 familjesh, të shtrira gjeografikisht në të gjithë vendin.

▪ GJENDJA FINANCIARE

Numri total i të punësuarve në kampionin e vrojtuar ka rënë krahasuar me gjashtëmujorin e kaluar dhe krahasuar me një vit më parë. Në terma vjetorë, kjo ka ardhur nga rënia e numrit të *të vetëpunësuarve*, ndërkohë që punësimi në *sektorin shtetëror* dhe atë *privat* ka rezultuar në rritje. Niveli i përgjithshëm i të ardhurave dhe shpenzimeve të familjeve *ka rënë gjatë periudhës* së vrojtuar, por rënia e shpenzimeve ka qenë më e theksuar, duke rezultuar në *një përmirësim të lehtë të balancës financiare* (të ardhura – shpenzime) të familjeve.

▪ HUAMARRJA

Rreth 24% e familjeve të përgjigjura (ose 261 familje), deklarojnë se kanë hua për të paguar në momentin e intervistimit, pavarësisht llojit, burimit apo vlerës së kësaj huaje. Kjo peshë ka vijuar të bjerë si krahasuar me gjashtëmujorin e kaluar dhe me një vit më parë (respektivisht me 2.2 pikë përqindje dhe 4.5 pikë përqindje), duke mbetur nën mesataren historike të vrojtimit prej rreth 29% e familjeve. Totali i tepricës së raportuar të huasë rezulton në rënie në terma gjashtëmujorë dhe vjetorë. Rreth 70% e vlerës së huasë është siguruar nga *burime formale* dhe 30% nga *burime joformale*. Kjo strukturë ka mbetur e pandryshuar krahasuar me gjashtëmujorin e kaluar, por në terma vjetorë është zhvendosur në favor të huasë joformale. Në përbërjen e tepricës sipas monedhës, rezulton se rreth 86% e saj deklarohet në lekë dhe 14% në euro dhe kjo shpërndarje ka mbetur e pandryshuar krahasuar me gjysmën e dytë të vitit 2018, por është zhvendosur në favor të monedhës vendase krahasuar me një vit më parë. Sipas qëllimit të përdorimit, rreth 37% e tepricës së huasë deklarohet për *blerjen/riparimin e një prone*, 31% për *zhvillimin e një biznesi* dhe vetëm 13% për *konsum*. Gjatë periudhës së vrojtuar, pesha e tepricës për 'blerje/riparim prone' është rritur në terma gjashtëmujorë dhe vjetorë, ndërkohë që pesha e tepricës për 'zhvillim biznesi' ka rezultuar në rënie.

▪ NGARKESA NË BORXH

Shumica e familjeve huamarrëse (82%) deklarojnë që *kësti i huasë* nuk ka ndryshuar gjatë gjashtëmujorit të vrojtuar. *Balanca neto* e pjesës tjetër të përgjigjeve tregon për një *rënie të kështit të kredisë* gjatë periudhës dhe me rritëm më të theksuar krahasuar me periudhën e kaluar. Rreth 61% e familjeve huamarrëse deklarojnë se *aftësia e tyre paguese nuk ka ndryshuar*, ndërsa balanca neto e pjesës tjetër të përgjigjeve rezulton në *përmirësim të aftësisë* së tyre paguese, si në terma gjashtëmujorë, ashtu edhe në terma vjetorë. Për gjashtëmujorin e dytë të vitit 2019, rreth 78% e familjeve nuk presin ndryshim të aftësisë së tyre paguese, ndërsa balanca neto e pjesës tjetër të të përgjigurve tregon ende për pritje pesimiste.

▪ PASURIA E FAMILJEVE

Rreth 98% e familjeve (total i kampionit të intervistuar) zotërojnë 1-2 prona të patundshme, kryesisht *shtëpi banimi* dhe kjo peshë është rritur me 2 pikë përqindje krahasuar me vrojtimin e kaluar; 2% deklarojnë se zotërojnë *më shumë se 2 prona të patundshme*, (shtëpi dhe tokë/dyqan etj.), dhe 1% kanë deklaruar se *nuk zotërojnë asnjë pronë*. Në grupin e familjeve që kanë deklaruar pasuri financiare, rezultojnë se *depozitat dhe/ose llogaritë bankare* vijojnë të mbeten lloji kryesor i investimit financiar si në rastin e totalit të familjeve (67% e rasteve) dhe në rastin e familjeve huamarrëse (80% e rasteve). Këto pesha kanë rezultuar në rritje krahasuar me gjashtëmujorin e kaluar, por kanë mbetur nën vlerat e një viti më parë.


1 -Karakteristikat demografike dhe financiare të familjeve të intervistuar

Karakteristikat e kampionit. Vrojtimi i radhës është kryer mbi kampionin rastësor prej 1210 familje¹, ku rreth 90% e tyre (1092 familje) kanë marrë pjesë në procesin e intervistimit, duke iu përgjigjur plotësisht ose pjesërisht pyetjeve të pyetësorit. Pesa e të përgjigurve ndaj totalit të kampionit ka rënë me 2 pikë përqindje krahasuar me vrojtimin e kaluar. Në totalin e familjeve të përgjigjura, rreth 56% banojnë në zonat urbane dhe 44% në zonat rurale të vendit.

Analiza në vijim i referohet vetëm familjeve që kanë dhënë përgjigje për secilën pyetje dhe të gjitha llogaritjet janë bërë mbi bazën e totalit të të përgjigurve.

1.1-Punësimi dhe burime të tjera të ardhurash. Numri total i anëtarëve të familjeve që sigurojnë të ardhura nga punësimi/vetëpunësimi në sektorin shtetëror, privat dhe/ose burime të tjera², ka shënuar rënie si në terma 6-mujorë (me 4.4%), ashtu edhe në terma vjetorë (me 2.3%) (Grafik 1.1).

Grafik 1.1 Shpërndarja e personave që sigurojnë të ardhura sipas llojit të burimit (në ndaj totalit të personave që sigurojnë të ardhura)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Shënim: Zëri 'Tjetër' përmbledh kryesisht rastet e personave që marrin asistencë invaliditeti, ndihmë nga të afërm dhe ata që bëjnë punë të rastit.

¹ Si pjesë e rishikimit të rregullt të kampionit të vrojtuar, për këtë vrojtim është rifreksuar nga INSTAT 20% e kampionit.

²Në pyetësor, përveç punësimit në sektorin shtetëror dhe privat, si burime të ardhurash listohen dhe: 'pensioni', 'asistencë sociale për papunësi', 'emigracioni' dhe zëri 'tjetër', ku përfshihet çdo lloj burimi tjetër që nuk është marrë parasysh në alternativat e dhëna.

Duke e fokusuar analizën *vetëm në pjesën e të punësuarve*³ të kampionit të vrojtuar (Tabelë 1.1), numri total i tyre ka shënuar rënie si krahasuar me 6 muaj më parë (me 4.9 %), ashtu edhe me një vit më parë (me 3.5%). Një terma 6-mujorë, rënia ka ardhur nga rënia e numrit të të punësuarve në sektorin shtetëror (me 5 %) dhe rënia e numrit të të vetëpunësuarve (me 10%). Në terma vjetorë, rënia e punësimit i atribuohet rënies së numrit të të vetëpunësuarve me 13%, ndërkohë që punësimi në sektorin shtetëror dhe atë privat ka rezultuar në rritje gjatë vitit me respektivisht 2.7% dhe 5.2%.

Tabelë 1.1 Numri i të punësuarve sipas sektorëve

		Shtetëror	Privat	Vetëpunësuar	Total të punësuar	Ndr. 6-mujor	Ndr. vjetor
V12	6MI_2016	283 (18%)	580 (37%)	691 (44%)	1554	7.0%	9.5%
V13	6MII_2016	272 (18%)	609 (40%)	633 (42%)	1514	-2.6%	4.2%
V14	6MI_2017	333 (21%)	575 (36%)	672 (43%)	1580	4.4%	1.7%
V15	6MII_2017	317 (21%)	595 (38%)	634 (41%)	1546	-2.2%	2.1%
V16	6MI_2018	259 (17%)	592(38%)	705 (45%)	1556	0.6%	-1.5%
V17	6MII_2018	280 (18%)	618(39%)	682 (43%)	1580	1.5%	2.2%
V18	6MI_2019	266 (18%)	623 (41%)	613 (41%)	1502	-4.9%	-3.5%


Burimi: Departamenti i Stabilitetit Financiar.

Shënim: Shifrat në kllapa janë peshat e secilit zë në raport me totalin e të punësuarve.

Numri i familjeve që kanë deklaruar dhe **burime të tjera të qëndrueshme të ardhurash**⁴ (si qira, interesa bankare etj.) ka rënë me 2 pikë përqindje krahasuar me vrojtimin e kaluar, duke arritur në 9% të të përgjigjurve ose gjithsej 94 familje. Në këtë grup familjesh, rreth 56% e tyre deklarojnë si burime alternative të ardhurash *'interesat nga kursimet (depozita, bono thesari etj.)'*, 30% deklarojnë të ardhura nga *'qiradhënia e pronave'*. Pjesa tjetër deklarojnë kombinim burimesh, kryesisht nga qiradhënia dhe interesat nga kursimet.


1.2-Të ardhurat dhe shpenzimet e familjeve. Gjatë 6-mujorit në analizë, struktura e shpërndarjes së familjeve sipas nivelit të të ardhurave, duket se është zhvendosur pak drejt niveleve të ulëta krahasuar me 6-mujorin e kaluar. Kështu, pjesa më e madhe e familjeve (rreth 53% e tyre) vijon të mbetet në nivelin *'17-50 mijë lekë'*. Nga ana tjetër, rreth 11% e tyre deklarojnë të ardhura të ulëta mujore *"deri në 17 mijë lekë"* (në rritje me 1 pikë përqindje krahasuar me 6-mujorin e dytë të vitit 2018), 27% deklarojnë të ardhura mujore *'50-100 mijë lekë'* dhe 7% deklarojnë të ardhura në nivelin *"100-200 mijë lekë"* (Grafik 1.2).

Grafik 1.2 Shpërndarja e familjeve sipas nivelit mujor të të ardhurave



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 1.3 Shpërndarja e familjeve sipas nivelit mujor të shpenzimeve




³Këtu janë përfshirë vetëm të punësuarit në sektorët shtetërorë, privat (bujqësor dhe jobujqësor) dhe të vetëpunësuar (në sektorët bujqësorë dhe jobujqësorë).

⁴ Në këtë pyetje, alternativat e listuara si burime të qëndrueshme të ardhurash janë: 1.qira, 2.interesa nga kursimet (depozita, bono thesari etj.), 3. interesa nga para të dhëna hua të të tretëve, 4.tjetër (përcakto).

Shpërndarja e familjeve sipas nivelit të shpenzimeve të domosdoshme të jetesës, gjithashtu është zhvendosur disi drejt një niveli më të ulët shpenzimesh mujore. Kështu, rreth 50.4% e të përgjigjurve vijnë të deklarojnë shpenzime mujore në nivelin '20-50 mijë lekë', dhe kjo peshë ka rënë me 2 pikë përqindje krahasuar me 6-mujorin e kaluar, por ka mbetur pothuaj e pandryshuar krahasuar me një vit më parë. Nga ana tjetër, pesha e familjeve që deklarojnë shpenzime në nivele të larta ('mbi 50 mijë lekë në muaj') ka shënuar rënie të lehtë në terma 6-mujorë dhe në terma vjetorë. Prirja e kundërt vihet re në rastin e dy grupeve me nivelet më të ulëta të shpenzimeve (Grafik 1.3).

Indeksi i të ardhurave⁵ dhe **Indeksi i shpenzimeve**⁶ kanë shënuar rënie gjatë periudhës së vrojtuar, por rënia e indeksit të shpenzimeve ka qenë më e theksuar, duke rezultuar në një *përmirësim të lehtë të balancës financiare (të ardhurave - shpenzime) të familjeve.*

Grafik 1.4 Indekset e të ardhurave dhe shpenzimeve të familjeve (2010=100)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Euroizimi i të ardhurave të familjeve shqiptare vijon të mbetet i ulët, ku vetëm 14% e të përgjigjurve (156 familje në 1118 familje të përgjigjura) deklarojnë se kanë të ardhura në valutë (kryesisht në euro) në raporte të ndryshme ndaj totalit të të ardhurave mujore⁷. Kjo peshë ka mbetur pothuaj e pandryshuar në dy vitet e fundit.

2- Huamarrja e familjeve

Në këtë vrojtim, numri i familjeve që deklarojnë se kanë *një ose më shumë hua për të paguar* në momentin e intervistimit, pavarësisht llojit, burimit apo vlerës së kësaj huaje, ka rezultuar në *261 familje ose rreth 24% e të përgjigjurve* (Grafik 2.1). Kjo peshë ka vijuar të bjerë si krahasuar me 6-mujorin e kaluar, ashtu edhe me një vit më parë (respektivisht me 2.2 pikë përqindje dhe 4.5 pikë përqindje), duke mbetur nën mesataren historike të vrojtimit prej rreth 29%.

⁵ 'Indeksi i të ardhurave' është ndërtuar si shumë e peshuar e frekuencave në % të përgjigjeve me koeficientët e përcaktuar për çdo interval si në vijim: 'deri në 17 mijë lekë' me 0.2; '17-50 mijë lekë' me 0.4; '50-100 mijë lekë' me 0.6; '100-200 mijë lekë' me 0.8; dhe 'mbi 200 mijë lekë' me 1. Vlerat e marra për çdo vit janë kthyer në indeks me bazë vitin 2010 = 100. Rritja e vlerës së indeksit nënkupton rritje të nivelit të të ardhurave mujore.


⁶ 'Indeksi i shpenzimeve' është ndërtuar si shumë e peshuar e frekuencave në % të përgjigjeve me koeficientët e përcaktuar për çdo interval si në vijim: 'deri në 10 mijë lekë' me 0.2; '10-20 mijë lekë' me 0.4; '20-50 mijë lekë' me 0.6; '50-100 mijë lekë' me 0.8 dhe 'mbi 100 mijë lekë' me 1. Vlerat e marra për çdo vit janë kthyer në indeks me bazë vitin 2010 =100. Rritja e vlerës së indeksit nënkupton rritje të nivelit të shpenzimeve të domosdoshme mujore.

⁷ Alternativat e lidhura me nivelin e të ardhurave në monedha të huaja janë: (1)'nuk kam fare', (2) 'deri në 10%', (3)'10-50%' dhe (4)'mbi 50%'.

2.1-Niveli i të ardhurave dhe shpenzimeve të familjeve huamarrëse. Gjatë 6-mujorit të vrojtuar, struktura e shpërndarjes së familjeve huamarrëse sipas të ardhurave të tyre duket se është zhvendosur disi drejt dy niveleve më të ulëta të të ardhurave, nivelit “deri në 17 mijë lekë” dhe nivelit ‘17-50 mijë lekë në muaj’, (në rritje respektivisht me 2.6 pikë përqindje dhe 1 pikë përqindje krahasuar me 6-mujorin e dytë të vitit 2018), ndërkohë që pesha e niveleve të tjera ka qenë kryesisht në rënie. Shpërndarja e huamarrësve sipas shpenzimeve (mujore) të domosdoshme të jetesës rezultojnë më e përqendruar në grupin me shpenzime ‘20-50 mijë lekë në muaj’ (52% e huamarrësve), në rënie me 4 pikë përqindje krahasuar me 6-mujorin e kaluar dhe në rritje me 3.7 pikë përqindje krahasuar me një vit më parë. Struktura e shpërndarjes së familjeve huamarrëse sipas nivelit të shpenzimeve, është zhvendosur disi drejt dy niveleve më të ulëta të shpenzimeve mujore.

Shpërndarja e mësipërme e familjeve huamarrëse sipas nivelit mujor të të ardhurave/shpenzimeve, ka rezultuar në rënie të vlerave të *indeksit të të ardhurave* dhe *indeksit të shpenzimeve* të tyre gjatë periudhës, por me një rënie pak më të theksuar në rastin e shpenzimeve (Grafik 2.1).

Grafik 2.1 Indeksi i të ardhurave dhe shpenzimeve të familjes huamarrëse (2010 = 100)




Burimi: Banka e Shqipërisë.

2.2-Qëllimet e huamarrjes. Qëllimet kryesore të huamarrjes mbeten: ‘për konsum’ në 33% të rasteve të huamarrjes, ‘për blerje/riparim i një prone’ në 28% të rasteve dhe për ‘zhvillim biznesi’ në 20% të rasteve. Pësia e rasteve të huamarrjes ‘për konsum’ ka rezultuar në rënie në terma gjashtëmujorë dhe vjetorë, ndërkohë që huamarrja për ‘blerje/riparim prone’ dhe ‘zhvillim biznesi’ ka rezultuar në rritje (Grafik 2.2).

Grafik 2.2 Huamarrja sipas QËLLIMIT të përdorimit të huasë (në % ndaj totalit të rasteve të huamarrjes)


⁸ Shënim metodologjik: meqë një familje mund të ketë më shumë se një hua për të paguar në periudhën referuese me karakteristika të ndryshme (burimi, qëllimi etj.), për të mos humbur informacionin, në këtë rubrikë, llogaritjet janë bërë mbi ‘totalin e rasteve të huamarrjes’ të deklaruara, përveçse kur specifikohet ‘...mbi totalin e huamarrësve (në këtë vrojtim = 261 familje). Me ‘raste huamarrjeje’ nënkuptojmë totalin e huave të marra nga e njëjta familje dhe më të njëjtën karakteristikë, p.sh.: një familje që deklaron 2 hua të marra nga banka përbën ‘1 rast huamarrjeje nga banka’ dhe një familje që ka një hua nga banka dhe një nga një person fizik, përbën ‘1 rast huamarrjeje nga banka’ dhe ‘1 rast huamarrjeje nga persona fizikë’.



Burimi: Banka e Shqipërisë.


2.3-Teprica e huasë. Duke e analizuar tepricën e deklaruar sipas burimit, rezulton se rreth 70% e saj vjen nga burime formale (banka dhe institucione financiare jobankare) dhe rreth 30% nga burime joformale (si persona fizikë, hua në formë malli etj.). Kjo strukturë ka mbetur e pandryshuar krahasuar me 6-mujorin e kaluar, por në terma vjetorë është zhvendosur në favor të huasë joformale, duke reflektuar rënien e tepricës së huasë nga 'bankat' dhe 'institucionet financiare jobankare'. Duke e analizuar tepricën e huamarrjes sipas qëllimit të përdorimit të saj (Grafik 2.3), rezulton se rreth 37% e saj është përdorur për 'blerjen/riparimin e një prone', 31% për 'zhvillimin e një biznesi' dhe 13% është përdorur me qëllim 'konsumi' (Grafik 2.4).

Grafik 2.3 Përbërja e tepricës sipas QËLLIMIT të huasë (në % ndaj totalit të tepricës së deklaruar)



Burimi: Banka e Shqipërisë.


Grafik 2.4 Përbërja e tepricës sipas MONEDHËS së huasë (në % ndaj totalit të tepricës së deklaruar)



Në përbërjen sipas monedhës, rezulton se 86% e kësaj teprice është në lekë, dhe 14% në valutë (euro) dhe kjo shpërndarje ka mbetur e pandryshuar krahasuar me gjysmën e dytë të vitit 2018, por është zhvendosur në favor të monedhës vendase krahasuar me një vit më parë (Grafik 2.4).

2.4-Format e huamarrjes. Në rreth 37% të rasteve të raportuara, huamarrja e familjeve rezulton në formën e 'kredisë nga institucione financiare', ku 32% e rasteve janë në trajtë 'kredie' dhe 5% janë në trajtë 'kartash krediti dhe overdraft'. Kjo peshë ka shënuar rritje me rreth 7 pikë përqindje krahasuar me 6-mujorin e kaluar dhe ka mbetur pothuaj e pandryshuar krahasuar me një vit më parë. Në rreth 43% të rasteve, huamarrja deklarohet në formën e 'parasë në dorë', duke shënuar një rënie të lehtë me 1 pikë përqindje krahasuar me 6-mujorin e kaluar. Peshë të konsiderueshme vijon të ketë zëri 'mall i papaguar' (19% e rasteve të huamarrjes), por në rënie graduale gjatë tre periudhave të fundit.


**Grafik 2.5 Huamarrja sipas FORMËS së huasë
(në % ndaj totalit të rasteve të huamarrjes)**



Burimi: Banka e Shqipërisë.

2.5-Pagesa e huasë. Dy format kryesore të pagesës së huasë vijojnë të mbeten pagesat 'me shumë të njëjtë çdo 1/3/6/12 muaj' (31% e rasteve të huamarrjes) dhe 'me shumë të ndryshueshme në periudha të ndryshme' (31% e rasteve të huamarrjes) (Grafik 2.6). Prirja e peshës së huamarrjes me këto dy forma pagese ka qenë e kundërt gjatë gjatshëmujorit të vrojtuar, ku në rastin e parë pesha ka rënë me 12 pikë përqindje dhe në rastin e dytë është rritur me 17 pikë përqindje.


**Grafik 2.6 Huamarrja sipas MËNYRAVE TË PAGESËS
(në % ndaj totalit të rasteve të huamarrjes)**



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Përsa i përket raportit të pagesës së huasë ndaj totalit të të ardhurave, nga përgjigjet rezultojnë se ky raport arrin 'deri në 10%' të të ardhurave mujore për 34% të familjeve huamarrëse, '10-30%' për 39% të familjeve dhe 'mbi 30%' të të ardhurave për rreth 26% të familjeve (Grafik 2.7). Në përgjithësi, gjatë tre vrojtimeve të fundit vihet re një prirje e kësaj shpërndarjeje për t'u zhvendosur në favor të raporteve më të larta këst/të ardhurave.


Grafik 2.7. Huamarrja sipas raportit 'kësti huasë/të ardhurat totale mujore' (në % ndaj totalit të rasteve të huamarrjes)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

2.6-Afati i mbetur deri në maturim. Në 53% të rasteve të huamarrjes deklarohet se huaja maturohet 'brenda një viti' dhe kjo peshë ka rënë me 1 pikë përqindje krahasuar me 6-mujorin e kaluar; në 42% të rasteve, afati i mbetur është '1-5 vjet' dhe në 5% të rasteve ka rezultuar 'mbi 5 vjet'.


Grafik 2.8 Huamarrja sipas MATURIMIT TË MBETUR të huasë (në % ndaj totalit të rasteve të huamarrjes)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

2.7-Garantimi i huamarrjes. Në 68% të rasteve të huamarrjes rezulton se huaja është 'e pagartuar' dhe kjo peshë është rritur rreth me 3 pikë përqindje krahasuar me 6-mujorin e kaluar dhe me 2 pikë përqindje krahasuar me një vit më parë. Priorja e kundërt vihet re në ecurinë e rasteve të huamarrjes së garantuar 'me një pronë të familjes'- në rënie në terma 6-mujorë, por pothuaj e pandryshuar krahasuar me një vit më parë.

Grafik 2.9 Huamarrja sipas FORMAVE TË GARANTIMIT të huasë (në % ndaj totalit të rasteve të huamarrjes)



Burimi: Banka e Shqipërisë.


Shënim: Zëri "tjetër" përmbledh rastet e huamarrjes së garantuar me forma të tjera, ku më shpesh përmendet garantimi i huasë përmes pagës, garantimit me një mall (si makina) etj.

3- Ngarkesa në borxh e familjeve

Në këtë seksion pyetjesh, familjeve huamarrëse u kërkohet të japin informacion vetëm për *huanë më të madhe* ekzistuese dhe që rëndon më shumë mbi ekonominë e familjes. Si rrjedhojë, peshat e përgjigjeve janë llogaritur mbi totalin e familjeve huamarrëse të përgjigjura për secilën pyetje.

3.1-Ndryshimi i kështit. Rreth 82% e familjeve huamarrëse të përgjigjura kanë deklaruar se kësti i huasë ka mbetur i pandryshuar gjatë 6-mujorit referues. *Balanca neto* e përgjigjeve të pjesës tjetër të familjeve huamarrëse (18% e familjeve huamarrëse) ka rezultuar -4.2 pikë përqindje, gjë që tregon për *rënie të kështit gjatë periudhës*, dhe me rritëm më të theksuar krahasuar me periudhën e kaluar.

Grafik 3.1 Ndryshimi i kështit mujor të huasë në 6 muajt e kaluar




Burimi: Banka e Shqipërisë.

3.2-Aftësia paguese në 6 muajt e kaluar dhe pritshmëritë për 6 muajt e ardhshëm. Rreth 61% e familjeve huamarrëse kanë deklaruar se aftësia e tyre paguese 'nuk ka ndryshuar' gjatë 6-mujorit të parë të 2019-ës dhe kjo peshë është rritur me 1 pikë përqindje krahasuar me 6-mujorin paraardhës.


Pjesa tjetër e të përgjigjurve, vlerësojnë në agregat *përmirësim* të aftësisë së tyre paguese, si në krahasim me gjashtëmujorin kaluar, ashtu edhe me një vit më parë (Grafik 3.2).

Grafik 3.2 Aftësia paguese në 6 muajt e kaluar



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 3.3 Pritshmëritë për aftësinë paguese në 6 muajt e ardhshëm



Për 6-mujorin e dytë të vitit 2019, rreth 78% e familjeve huamarrëse nuk presin ndryshim të aftësisë së tyre paguese (në rënie me 2 pikë përqindje krahasuar me vërtetimin e kaluar), ndërsa balanca neto e përgjigjeve të pjesës tjetër ka rezultuar - 5.7 pikë përqindje, gjë që tregon se familjet presin 'përkeqësim' të aftësisë së tyre paguese në 6 muajt e ardhshëm (Grafik 3.3) dhe kjo prirje ka ardhur duke u theksuar në dy vitet e fundit.

3.3-Pritshmëritë mbi marrjen e një huaje të re në 6 muajt e ardhshëm⁹. Rreth 67% e të përgjigjurve kanë deklaruar se 'nuk presin të marrin hua të re në 6 muajt e ardhshëm', dhe kjo peshë është rritur krahasuar me 6-mujorin e kaluar dhe me një vit më parë. Nga ana tjetër, rreth 33% e të përgjigjurve (ose 359 familje), deklarojnë se e konsiderojnë në shkallë të ndryshme sigurie¹⁰ mundësinë për të marrë/rimarrë një hua të re gjatë periudhës në fjalë dhe kjo peshë ka rënë me 4 pikë përqindje krahasuar me 6-mujorin e kaluar dhe me 5 pikë përqindje krahasuar me një vit më parë.

Si rezultat, *indeksi i mundësisë për të rimarrë një hua të re*¹¹ ka rezultuar 0.149, duke shënuar rënie krahasuar me vërtetimin e kaluar dhe krahasuar me një vit më parë, dhe duke mbetur nën vlerën e mesatares afatgjatë të tij (Grafik 3.4). Kjo ecuri vijon të dëshmojë për një kërkesë ende të paqëndrueshme të familjeve për huamarrje.

Duke analizuar vetëm grupin e familjeve që *planifikojnë të marrin një hua të re (359 familje)*, rezulton se më shumë se gjysma e tyre (59%) janë 'huamarrës të rinj', pra që nuk kanë hua të papaguar në momentin e intervistimit (Grafik 3.5) dhe 41% janë 'huamarrës ekzistues'. Këto pesha kanë mbetur në


⁹ Pyetja i drejtohet të gjithë kampionit prej 1210 familjesh dhe asaj i janë përgjigjur 1092 familje ose rreth 90% e totalit të kampionit.

¹⁰ Alternativat e dhëna janë: 'ka pak mundësi', 'ka shumë mundësi' dhe 'është e sigurt'.

¹¹ Indeksi është llogaritur si mesatare e peshuar e % së përgjigjeve për secilën alternativë me koeficientët përkatës. Për përcaktimin e koeficientëve, intervali 0-1 është ndarë në 4 nën-intervale me gjatësi të barabartë 0.33. Koeficientët për secilën alternativë rezultojnë: 0 ('nuk ka asnjë mundësi'), 0.33 ('ka pak mundësi'), 0.66 ('ka shumë mundësi') dhe 1 ('është e sigurt'). Indeksi i përfutur merr vlera nga 0 në 1, ku sa më afër 0 të rezultojë vlera e indeksit, aq më e vogël është mundësia për të marrë hua të re dhe, sa më afër 1-shit, aq më e lartë mundësia për të marrë hua të re në 6 muajt e ardhshëm.


të njëjta nivele të rezultuar në 6-mujorin e kaluar, gjë që konfirmon kërkesën ende të ndrydhur të familjeve për huamarrje.

Grafik 3.4 Indeksi i planifikimit të marrjes së një huaje në 6 muajt e ardhshëm



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 3.5 Familjet që planifikojnë të marrin hua në 6 muajt e ardhshëm




4- Pasuria e familjeve

Kjo rubrikë përmban vetëm 2 pyetje mbi pronat e patundshme dhe pasurinë financiare të familjeve të intervistuar dhe i drejtohet të gjithë kampionit të familjeve. Rezultatet për 6-mujorin e parë të vitit 2019, paraqiten si më poshtë:


4.1-Pasuritë e patundshme të familjeve. Për këtë seksion pyetjesh kanë dhënë përgjigje 1049 familje, të cilat kanë deklaruar se zotërojnë në total 1561 prona të patundshme të llojeve të ndryshme ku: 98% (1023 familje) e tyre zotërojnë '1-2 prona të patundshme' kryesisht të llojit 'shtëpi banimi' ose kombinim i një shtëpie banimi dhe një prone tjetër si 'tokë', 'dyqan', 'godinë' etj., (kjo peshë është rritur me 2 pikë përqindje krahasuar me vrojtimin e kaluar) dhe 2% e të përgjigjurve (ose 26 familje) deklarojnë se zotërojnë 'më shumë se 2 prona të patundshme' (Grafik 4.1).

Grafik 4.1 Shpërndarja e familjeve (total kampioni) sipas numrit të pronave që zotërojnë (në % ndaj totalit të familjeve të përgjigjura)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 4.2 Shpërndarja e familjeve huamarrëse sipas numrit të pronave që zotërojnë (në % ndaj totalit të familjeve të përgjigjura)




Duke e fokusuar analizën vetëm në grupin e **familjeve huamarrëse** (261 familje), rezulton se familjet e përgjigjura (247 familje) deklarojnë gjithsej 397 prona të patundshme, ku 63% e tyre janë të llojit 'shtëpi', 32% të llojit 'tokë' dhe pjesa tjetër janë 'dyqane' dhe 'godina' dhe lloje të tjera pronash.

Në shpërndarjen e familjeve huamarrëse sipas numrit të pronave që zotërojnë rezulton se: rreth 96% e tyre (236 familje) zotërojnë '1-2 prona të patundshme' në momentin e intervistimit, dhe kjo peshë është rritur me 2 pikë përqindje krahasuar me vrojtimin e kaluar. Në shumicën e rasteve këto prona janë një shtëpi banimi ose kombinimi i një shtëpie dhe një sipërfaqe toke. Vetëm 4% e familjeve huamarrëse (14 familje) deklarojnë se zotërojnë 'më shumë se dy prona' dhe kjo peshë nuk ka ndryshuar krahasuar me vrojtimin e 6-mujorit të kaluar (Grafik 4.2).


4.2-Pasuritë financiare të familjeve¹². Nga përgjigjet e dhëna, rezulton se për periudhën e vrojtuar, 43% e totalit të familjeve të kampionit të vrojtuar (huamarrëse dhe johuamarrëse) dhe 52% e grupit të familjeve huamarrëse, deklarojnë se 'nuk zotërojnë asnjë lloj pasurie financiare' dhe të dyja këto pesha janë rritur respektivisht me 8 pikë përqindje dhe 1 pikë përqindje krahasuar me vrojtimin e kaluar. Duke analizuar vetëm pjesën e familjeve që kanë deklaruar pasuri financiare të formave të ndryshme (duke përfshirë rastet që 'nuk kanë asnjë lloj pasurie financiare'), rezulton se 'depozitat dhe/ose llogaritë bankare' vijojnë të mbeten lloji kryesor i investimit financiar, si në rastin e totalit të kampionit të familjeve (67% e rasteve të raportuara) dhe në rastin e familjeve huamarrëse (80% e rasteve të raportuara), dhe këto pesha kanë rezultuar në rritje krahasuar me 6-mujorin e kaluar, por duke mbetur nën vlerat e një viti më parë. Nga ana tjetër, përdorimi i formave të tjera të investimit të pasurisë financiare, të përmbledhura në termin "investime të tjera"¹³, ka mbetur e pandryshuar për totalin e kampionit të vrojtuar, por në rënie në grupin e familjeve huamarrëse. (Grafik 4.3 dhe Grafik 4.4).

Grafik 4.3 Shpërndarja e familjeve (total kampioni) sipas llojit të pasurisë financiare (në % ndaj totalit të rasteve të deklaruara)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 4.4 Shpërndarja e familjeve huamarrëse sipas llojit të pasurisë financiare (në % ndaj totalit të rasteve të deklaruara)



Në përgjithësi, pesha e rasteve të mbajtjes së pasurisë financiare brenda sistemit (ku përfshihen depozita/llogari bankare dhe investime të tjera), ka shënuar rritje për totalin e familjeve kundrejt peshës së rasteve të pasurisë së mbajtur jashtë sistemit (ku përfshihen kursime në para të mbajtura jashtë banke ose të dhëna hua).

¹² Pyetjes mbi pasuritë financiare në pronësi të familjeve të intervistuar i janë përgjigjur 1118 familje që kanë marrë pjesë në vrojtimit.

¹³ Në zërin "Investime të tjera" përmbledhen rastet e investimeve në: bono thesari, sigurim jete, fond pensioni privat dhe aksione.

